

Vendim nr. 82 datë 20.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 20.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: ALBERTA GEGA

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga vendimi nr. 00-2022-461(98), datë 29.03.2022 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 122, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, pika 1, dhe 134, pika 1, shkronja “1”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 e 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasja Alberta Gega (*kërkuesja*) ka lidhur një kontratë porosie me shtetasin D.M. në vitin 2007, përmes së cilës i ka paguar asaj shumë 100.000 Euro përkundrejt veprimeve që do të kryente në cilësinë e avokates për dokumentacionin ligjor për një shesh ndërtimi. Pavarësisht mospërbushjes së detyrimeve të kontratës, kërkuesja nuk ia ka kthyer shtetasit D.M. shumë e plotë të marrë në bazë të saj. Në këto kushte, ai ka depozituar kallëzim penal ndaj saj.

2. Mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit D.M., Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 1963, datë 02.05.2011 për akuzën e kryerjes së veprës penale “*Mashtrimi*”, të parashikuar nga neni 143, paragrafi 2, i Kodit Penal (*KP*), në ngarkim të kërkueses. Në përfundim të hetimeve, organi i akuzës ka paraqitur kërkesë për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1037, datë 03.07.2012, ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të saj. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 363, datë 10.04.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1037, datë 03.07.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

5. Në procesin e rigjyimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2857, datë 27.07.2015, ka vendosur: “*Deklarimin të pafajshme të të pandehurës Alberta Gega, për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/2, i Kodit Penal. [...]*”, pasi nuk e ka gjetur të bazuar akuzën e organit të prokurorisë për veprën penale të mashtrimit.

6. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet të cilit ka kërkuar ndryshimin e vendimit, deklarin fajtores të kërkueses për kryerjen e veprës penale të sipërcituar dhe dënimin e saj me 12 vjet burgim. Ndërkohë, kërkuesja ka paraqitur apel kundërshtues, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. 2857, datë 27.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1144, datë 28.09.2016, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 2857, datë 27.7.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë*.”, pasi ka konstatuar se veprimet e së pandehurës nuk plotësojnë elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet. Kundër këtij vendimi ka

ushtuar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-461 (98), datë 29.03.2022, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 1144, datë 28.09.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.”*.

9. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykatës) me ankim kushtetues individual për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga vendimi nr. 00-2022-461(98), datë 29.03.2022 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Fillimisht, kërkesa është paraqitur në datën 13.02.2023 dhe pasi ajo është plotësuar, është regjistruar në datën 01.03.2023.

II

Pretendimet e kërkueses

10. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspekt të:

10.1. *Së drejtës së mbrojtjes dhe për t’u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë duhet ta gjykonte çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve dhe jo në dhomën e këshillimit, në kushtet kur çështja e saj ishte komplekse. E drejta për të qenë i pranishëm në gjykim është pjesë e së drejtës për t’u mbrojtur dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është shprehur se i akuzuari në procesin penal duhet të jetë i pranishëm në seancë gjyqësore.

10.2. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka kryer shqyrtim të provave dhe ligjit material, ndërkohë që duhet ta shqyrtonte çështjen vetëm në aspekt të shkeljeve të dispozitave procedurale gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e faktit. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë duhej t’u kërkonte palëve shkeljet e pretenduara nga të dyja gjykatat e faktit dhe kjo duhet të realizohej me praninë e tyre në seancë gjyqësore dhe jo në dhomën e këshillimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuases

11. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuësja të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

13. Kolegji vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues, e për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuësja përpara se t’i drejtohet Gjykatës.

15. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuësja duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimin nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, kjo do të thotë se mund të kërkohet vetëm për një vendim

gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkesja ka kundërshtuar vendimin nr. 00-2022-461(98), datë 29.03.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1144, datë 28.09.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Për shkak të kthimit të çështjes për rishqyrtim, procesi gjyqësor për përcaktimin ose jo të fajësisë së kërkujes vazhdon ende të gjykohet në themel nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto kushte, vendimi nr. 00-2022-461(98), datë 29.03.2022 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk mund të konsiderohet përfundimtar në kuptim të vendimit gjyqësor për të cilin janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi në të tilla raste kërkesja i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të saj gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr.39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Mbështetur në standardet e mësipërme kushtetuese dhe referuar rrethanave të rastit në shqyrtim, në kushtet kur çështja është kthyer për rishqyrtim dhe procedurat gjyqësore për shqyrtimin e saj në themel nuk kanë përfunduar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriterin paraprak të shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

18. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vendimi objekt i ankimit kushtetues individual nuk ka vendosur në mënyrë përfundimtare për çështjen gjyqësore, prandaj kërkesja nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.